

PERMBLEDHJE E RAPORTIT E VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

**EMËRTIMI I PROJEKTIT:
PRODHIM I GAZIT SO₂.**

VENDODHJA:

**UZINA 12, ISH KOMBINATI METALURGJIK, NJËSIA
ADMINISTRATIVE BRADASHESH, BASHKIA ELBASAN, QARKU
ELBASAN.**

Sipas shtojces 1 te Ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 “Per lejet e mjedisit”, i ndryshuar,
pika 6.b. Prodhimi i kimikateve inorganike baze . (Proçedure e thelluar e VNM-se).

Kërkues:

“ELBAGAS” SH.A (z. LUAN MALO)

**ELBASAN, NJESIA ADMINISTRATIVE BRADASHESH, UZINA 12 E
ISH KOMBINATIT METALURGJIK**

Ky raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis u hartua nga

Studio “Elbasani”

Eksperti Mjedisor

Ing. Lila Karaj

Shtator, 2016

TABELA:

STRUKTURA E RENDITJES DHE INFORMACIONIT QË PËRMBAN KY RAPORT

Hyrje

1. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHEM TË ZBATOHET PROJEKTI.	3
2. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.	8
3. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.	11
4. PËRSHKRIMI I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.	13
5. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.	14
6. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS 14	14
7. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.....	15
8. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.	15
9. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR	15

HYRJE

Pershkrim i procesit teknologjik

Prodhimi i bioksidit të squfurit (SO₂), realizohet nga djegia e squfurit të ngurte në prani të oksigjenit me tepricë, ky proces ndodh në një furrë të specializuar për këto qëllime dhe me tej mbledhjen, pastrimin dhe komprimimin e bioksidit të squfurit (SO₂), duke e shndërruar atë në një gjendje të gaztë në të cilën lenget për të depozituar në depozitën kryesore dhe më pas prej saj për të depozituar e mbushur në bombulat e vogla për qëllime tregtimi. Në këtë mënyrë prodhohet një produkt cilësor me parametrat e duhur vendas dhe të huaj, pasi një pjesë e mirë e tij shitet për eksport, kryesisht në vendet fqinje.

2.1. Pershkrimi i projektit teknologjik

2.1.1 Hyrje

Ky projekt përfshin të gjitha të dhënat e informacionet teknike të nevojshme për realizimin e tij si dhe shfrytëzimin e objektit në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Në përgjithësi objekti përmban:

- Linjen e Prodhimit të SO₂.
- Sistemin e Lengezimit të SO₂ (Kompresoret e SO₂, këmbesit e nxehtësise).
- Depozitat e SO₂ të lenget, 4 rezervuare me volum gjeometrik të përgjithshëm prej 235 m³.
- Sektori i mbushjes së bombolave e fuçive të SO₂, me dy poste mbushjeje, me zona të veçanta për vendosjen e bombolave e fuçive boshe dhe plote.
- Sistemin e ujit ftohes dhe zjarrfikës, i përbërë nga pusi i ujit me pompen perkatese, një depozitë uji me kapacitet 50 m³, pompa e ujit ftohes (dhe zjarrfikës).
- Sektorin e Kontrollit Teknik Periodik të bombolave e fuçive të SO₂.
- Sektoret ndihmes si: zyra, dhoma e personelit, magazina, ofiçina, kabina elektrike.

2.1.2 Funkcionimi dhe kapacitetet

Në objekt kryhen: prodhimi i SO₂ të lenget, mbushja e bombolave e fuçive të SO₂ si dhe kontrolli teknik i bombolave e fuçive të SO₂. Kapaciteti normal i prodhimit është rreth 160 kg SO₂/ore, kapaciteti ruajtës/mbajtës i depozitave është rreth 290 Ton SO₂; kapaciteti për mbushjen e bombolave e fuçive të SO₂ është rreth 1000 kg SO₂/ore, kapaciteti për mbushjen e cisternave është rreth 5 Ton SO₂/ore.

2.1.3 Dokumentet baze

Projekti është hartuar në baze të detyrës së projektimit të hartuar në marrëveshje me z. Luan Malo (Administrator i ELBAGAS ShA, Elbasan) dhe të plan-vendosjes.

2.2 Baza e projektit

2.2.1 Specifikimi i produktit

Dioksid Squfuri i Lenget

Formula kimike:	SO ₂
Formula Molekulare (Hill):	O2-S1
Pesha molekulare/MWt:	64,06
Pika e shkrirjes:	-75,5 °C
Pika e vlimit:	-10,02 °C (1013,25 hPa)
Temperatura kritike:	157,5 °C
Presioni kritik:	78,8 bar
Presioni i avullit:	3,3 bar (20 °C) 4,6 bar (30 °C) 6,3 bar (40 °C) 8,4 bar (50 °C) 11,1 bar (60 °C)
Pika e ndezjes:	nuk ka pike ndezje
Vetite oksiduese:	nuk është gaz që merr flakë
Ndezja spontane (solid):	produkti nuk është i vetëndezshëm
Rreziku për eksplozion :	Substanca nuk është eksplozive
Temperatura e ndezjes:	nuk aplikohet
Densiteti:	1,434 g/cm ³ (SO ₂ i lenget, 0 °C) 1,360 g/cm ³ (SO ₂ i lenget, 25 °C)

2.2.2.Linja e Prodhimit të SO₂

- a) **Furra e prodhimit të SO₂** të gazte, me prodhimtari rreth 160 kg SO₂/ore. Është ene cilindrike, horizontale, e prodhuar prej çeliku inoksidabel. Janë dy furra, një për secilin linjë.
- b) **Spektori i filtrimit të SO₂** të gazte:
 - **Dhoma e sublimitimit**, ku ndodh zgjerimi dhe ftohja e SO₂ të sapo dalë nga furra, kondensimi dhe dekantimi i grimcave të sqfurit të padjegur në furë. Është ene cilindrike me konik në pjesën e poshtme, vertikale, e prodhuar prej

çeliku inoksidabel. Jane dy ene, nje per secilen linje.

- **Ndaresi me unaza “Rashing”**, ku ndodh filtrimi i metejshe i SO₂. Eshte ene vertikale, me konik ne pjesen e poshtme, e prodhuar prej çeliku inoksidabel. Jane dy ene, nje per secilen linje.
- **Ndaresi me glicerine**, ku ndodh filtrimi i metejshe i SO₂. Eshte ene cilindrike, vertikale, me konik ne pjesen e poshtme, e prodhuar prej çeliku inoksidabel. Jane dy ene, nje per secilen linje.
- **Kapesi i pikave te glicerines**, ku ndodh kapja e pikave te glicerines, te cilat shoqerojne gazin qe nga dalja e ndaresit me glicerine. Eshte ene cilindrike, vertikale, e prodhuar prej çeliku inoksidabel. Jane dy ene, nje per secilen linje.
- **Kolona ndarese fundore**, ku ndodh filtrimi i metejshe i SO₂. Eshte ene cilindrike, vertikale me lartesi te konsiderueshme, e prodhuar prej çeliku te zakonshem. Jane dy ene, nje per secilen linje.

2.2.3. Sektori i lengezimit te SO₂

- **Kompresori i SO₂**, me prodhimtari rreth 160 kg SO₂/ore. Eshte kompresor me pistone, vertikal, me nje shkalle shtypje. Jane kater kompresore, dy per secilen linje.
- **Kembyesi i nxehtesise**, me kapacitet ftohes/lengezues rreth 180 kg SO₂/ore. Eshte kembyes nxehtesie me uje, prodhuar me tuba çeliku inoksidabel. Jane tre kembyes nxehtesie.

2.2.4. Depozitat e SO₂ te Lenget

- Dy **rezervuare cilindrike, horizontale**, per dioksid squfuri te lenget, me vellim gjeometrik 80 m³ secili, me numer fabrikimi KME-RS80-01 dhe KME-RS80-02, prodhim shqiptar.
- Nje **rezervuar sferik**, per dioksid squfuri te lenget, me vellim gjeometrik 50 m³, me numer fabrikimi KME-RS50-S, prodhim shqiptar.
- Nje **rezervuar cilindrik, horizontal**, per dioksid squfuri te lenget, me vellim gjeometrik 25 m³, me numer fabrikimi KME-RS25, prodhim shqiptar.

Te gjithë rezervuaret e dioksidit të sqfurit të lenget pajisen me keto instrumenta dhe aksesore:

- a) Valvola sigurimi të tipit me suste, me kapacitet të mjaftueshëm për volumnin e tyre;
- b) Tregues niveli të lengut në rezervuar, me galexhant me trasmesion magnetik;
- c) Manometer për matjen e presionit të rezervuareve në kapelen gazore, me fushe matjeje 0 deri 10 bar;
- d) Termometer për matjen e temperaturës së lengut në rezervuar, me fushe matjeje 0 deri 100 °C.

2.2.5. Mbushja e bombolave e cisternave të SO₂

- **Zona e mbushjes së bombolave e cisternave të SO₂**, me sipërfaqe rreth 60 m², përmban dy peshore dhe dy pika mbushjeje. Në linjen hyrëse të SO₂ të lenget është vendosur një filter, ndërsa linja e rikthimit shërben për uljen e presionit në bombolen që mbushet. Mbushja e bombolave dhe cisternave me SO₂ të lenget bëhet me presionin e vetë depozitave të SO₂ të lenget, presion që mund të rritet, në rast nevojë,

INFORMACION PËR NDËRVEPRIMIN NË MJEDIS “Linjen e Prodhimit të SO₂ dhe e mbushjes së bombolave e cisternave me SO₂“

UZINA 12 E ISH KOMBINATIT METALURGIJK, BRADASHESH, ELBASAN.

me ane të kompresoreve të SO₂. Kjo zonë është e mbuluar plotësisht nga një vinç ure me kapacitet 3 Ton, është e hapur dhe e ajrosur shumë mire.

- **Zona e magazinimit të bombolave e fuçive plote të SO₂**, me sipërfaqe rreth 60 m², është vazhdim i zonës së mbushjes. Kjo zonë është e mbuluar plotësisht nga një vinç ure me kapacitet 3 Ton, është e hapur dhe e ajrosur shumë mire.
- **Zona e magazinimit të bombolave e fuçive boshe të SO₂**, me sipërfaqe rreth 60 m², është vazhdim i zonës së magazinimit të bombolave e fuçive plote. Kjo zonë është e mbuluar plotësisht nga një vinç ure me kapacitet 3 Ton, është e hapur dhe e ajrosur shumë mire.

2.2.6 Kontrolli teknik i bombolave e fuçive të SO₂

Zona e kontrollit teknik periodik të bombolave e fuçive të SO₂, me sipërfaqe rreth 120 m², është vazhdim i zonës së magazinimit të bombolave e fuçive boshe. Janë të vendosura në mënyrë fikse rampi ku kryhet prova e presionit hidraulik dhe bangoja me pajisjet e kontrollit të ventileve. Në këtë zonë janë të vendosura edhe pompa elektrike për proven të presionit hidraulik, dy peshore ku përcaktohet tara e bombolave e fuçive, mbajtësi i rrotullueshëm i fuçive, stanoku i bombolave për heqjen dhe vendosjen e ventileve, pompa e vakumit për tharjen e bombolave e fuçive etj.

Kjo zonë është e mbuluar plotësisht nga një vinç ure me kapacitet 3 Ton, është e hapur dhe e ajrosur shumë mire.

2.3 Kriteret e përgjithshme dhe filozofia e projektimit

2.3.1 **Presioni dhe temperatura e projektimit** Linja e prodhimit të SO₂ të lenget dhe e mbushjes së bombolave e fuçive konceptohet të jetë e përbërë nga:

a) Pjesa e linjes e presionit të ulët

- pjesa e linjes që punon nën presionin $\leq 0,5$ bar dhe përfshin furrën e prodhimit të SO₂ të gaztë dhe sektorin e filtrimit;

Presioni i projektit Pn 0,75 bar. Temperatura: furra e SO₂ deri 500 °C, gjithë të tjerat deri 100 °C.

Të gjitha enët dhe tubacionet, berrylat, Ti-te, reduksionet, armaturat, janë prej çeliku inoksidabel. Disa fllanxha janë çelik A105, sipas UNI 6084-67. Të gjitha armaturat, Pn 16 bar.

b) Pjesa e linjes e presionit të lartë

- pjesa që punon nën presionin e punës deri 8 bar dhe përfshin sektorin e lengezimit (kompresoret dhe kembyesit e nxehtësise), depozitat e SO₂ të lenget, sektorin e mbushjes së bombolave e fuçive të SO₂.

Presioni i projektit Pn 12 bar. Temperatura: deri 100 °C.

Të gjithë tubacionet, berrylat, Ti-te, reduksionet, armaturat, janë prej çeliku inoksidabel. Valvolat e sigurimit tarohen në 8,8 bar.

INFORMACION PËR NDËRVEPRIMIN NË MJEDIS “Linjen e Prodhimit të SO₂ dhe e mbushjes së bombolave e cisternave me SO₂“

UZINA 12 E ISH KOMBINATIT METALURGIK, BRADASHESH, ELBASAN.

- Sektori i kontrollit teknik të bombolave e fuçive të SO₂ (sistemi i provës së presionit hidraulik), ku përfshihen tubacionet prej çeliku inoksidabel, lidhësit fleksibel, armaturat, parashikohet me Pn 30 bar. Valvola e sigurisë e linjës së provës së presionit, tarohet në 14,5 bar. Temperatura deri 50 °C.

c) Rezervuarët

- Të gjithë depozitat/rezervuarët e SO₂ të lenget, duhet të plotësojnë këto parametra projektimi:

- Presioni i punës 8 bar
- Presioni i provës 12 bar

- Temperatura maksimale e punës 50 °C
- Tarimi i valvolave të sigurimit 8,8 bar
- Niveli maksimal i mbushjes 85 %
- **Të gjitha flanaxhat dhe armaturat e rezervuarëve, Pn 16 bar.**

3. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHEM TË ZBATOHET PROJEKTI.

Aktiviteti në vlerësim është një instalim i cili prodhon në rrugë industriale Gazin SO₂. Ky aktivitet është ekzistues dhe ndodhet në brendësi të Kombinatit Metalurgjik, pranë Uzines 12, Njësia Vendore Bradashesh, Bashkia Elbasan. Terreni është i sheshtë dhe ndodhet në zonë industriale. Bimësia që karakterizon këto zone, për rrethinat të cilat janë të banuara dhe të lira nga ndërtimet janë kulturat bujqësore dhe bimësia barishtore e pemeve të larta, por këto të fundit të rralla e jo në trajtë pyjesh e habitatësh. Kulturat bujqësore të zonës variojnë nga me të ndryshmet, duke përmendur drithërat, foragjeret, perimet, pemet frutore, agrumet, vreshtat e rrushit, ullinjte, etj. Bimësia e rajonit është kryesisht shkurre-barishtore dhe pjesërisht dru pyjorë në lartësi të maleve e kodrave (edhe përgjatë kanaleve kullues dhe në oborret e banesave dhe objekteve private). Siç shihet edhe nga ortofotot dhe nga fotot e zonës, ky aktivitet ndodhet në një zonë industriale, në kantonet të vjetra ekzistuese të cilat kanë funksionuar historikisht si të tilla për prodhimin në rrugë industriale të Gazit SO₂ (Bioksid Squfuri). Madje edhe një pjesë të makinerive të perpunimit janë të teknologjive ekzistuese të Kombinatit Metalurgjik. Pra ky aktivitet nuk prek zonë pyjorë, apo zonë të mbrojtura me ligj. Nuk do të ketë ndërtim të ri dhe nuk do të zihet sipërfaqe e re toke. Objektet janë të hipotekuara. Për sa i përket Klimes, ajo është tipike mesdhetare, kontinentale dhe vecanerisht kjo zonë karakterizohet nga një klimë e bute e me rreshje të rregullta. Dimri është i bute, ndërsa pranvera dhe vera janë muaj të nxehtë. Kjo zonë është e pasur me burime ujore dhe karakterizohet nga një numër rezervuarësh bujqësorë, nga Lumi Shkumbin dhe deget e tij, etj.

Pamje satelitore e sipërfaqes në vlerësim dhe bimesisë së zonës pranë Pamje satelitore e vitit 2005

Koordinatat e objektit në sistemin Gaus-Krüge		
Nr.	Koordinatat Y	Koordinatat X
1		
2		
3		
4		
S=.....m ²		

INFORMACION PËR NDËRVEPRIMIN NË MJEDIS “Linjen e Prodhimit te SO₂ dhe e mbushjes se bombolave e cisternave me SO₂“

UZINA 12 E ISH KOMBINATIT METALURGIJK, BRADASHESH, ELBASAN.

Foto ilustrative te aktivitetit



Pamje e zones industriale (Ish Uzina 12)



Informacion rreth bimesise dhe zonave të mbrojtura të rajonit.

Në Shqipëri, zonat e mbrojtura sidomos 10 vjeçarit e fundit, janë kthyer në një objekt të rëndësishëm pune të disa institucioneve të vendit, të cilat kanë synuar në evidentimin, ruajtjen, mirëmenaxhimin e përdorimin në mënyrë të qëndrueshme të tyre.

Aktualisht në Shqipëri zonat e mbrojtura përbëjnë rreth 10% të territorit. Ndonëse shpallja e tyre është bërë gradualisht ndër vite, duke filluar që në vitin 1940, deri në vitin 2002 ka munguar një ligj mbi të cilin të mbeshtetet kategorizimi, ruajtja e menaxhimi i këtyre zonave. Me daljen e këtij ligji në qershor të 2002 duhet thënë se ka filluar një koncept i ri që përshtatet me atë bashkëkohor dhe që në tre vitet e fundit ka gjetur zbatim në rritjen me dyfish të territorit të vendit. Rrjeti i zonave të mbrojtura mbështetet në kategoritë menaxhuese të Qendrës Ndërkombëtare për Ruajtjen e Natyrës (IUCN).

Themelet e zonave të mbrojtura janë hedhur që në vitin 1940 me shpalljen/krijimin e Rezervatit të Parë Shtetëror të Gjuetisë (Kune- Vain-Tale) në Lezhë dhe në Parkun Kombëtar “Mali i Tomorrit” në Berat. Në vitin 1956, në mbështetje të Dekretit “Mbi gjuetinë dhe peshkimin në ujërat malorë” u krijua rezervati i gjuetisë në Rrushkull.

Në vitin 1960, zyrtarisht krijohet Parku Kombëtar “Mali i Dajtit” dhe 6 vjet më vonë numri i tyre rritet në 6 (Thethi, Lura, Llogaraja, Dajti dhe Drenova). Parqe Kombëtare u shpallën zona me vlera të rralla e të veçanta natyrore, shkencore, shoqërore e rekreative, ku ruheshin të pa prekur ekosistemet natyrore dhe shërbenin për ruajtjen e florës dhe faunës së egër. Deri në vitin 1970 numri i rezervateve të gjuetisë arriti në 15 zona pyjore e lagunore. Me dekretin e vitit 1977 u bë riklasifikimi i rezervateve të gjuetisë dhe numri i tyre arriti në 25. Në vitin 1981 për herë të parë u vunë në mbrojtje shtetërore pasuritë natyrore të rralla, duke shpallur Monumente Natyre drurët e grumbuj pyjorë me vlerë shkencore, biologjike, historike e didaktike.

Lagunat Bregdetare

Lagunat bregdetare ose tokat e lagura në bregdet janë ekosistemet më të rëndësishëm të biodiversitetit shqiptar dhe për vlerat socioekonomike që ofrojnë. Vetëm në rreth 3% të sipërfaqes së vendit që mbulohet nga këto zona, përmbledhet rreth 70% e llojeve të ruazorëve të vendit. Ato paraqiten si një zinxhir që përshkon të gjithë vijën bregdetare ku përmendim nga veriu në jug Velipojën, sistemin e Kune-Vainit, Patokun, Rrushkullin, Karavastanë, Nartën, Orikumin, Butrintin, etj. Veçanërisht të rëndësishme shfaqen ato për grupin e shpendëve, kryesisht për dimërimin e shpendëve shtegtarë të ujit, dhe të amfibëve duke u ndjekur nga reptilët dhe gjitarët.

Rëndësia e Shqipërisë për llojet shtegtare

Shqipëria është një udhëkryq i rëndësishëm për migrimin e shpendëve, lakuriqve të natës dhe insekteve. Çdo vit takohen rreth 70 lloje shpendësh uji me një popullatë totale prej 180.000 individësh në Shqipëri gjatë dimrit. 2 nga 9 llojet e shpendëve endemikë Europianë janë gjithashtu prezent në vendin tonë (Trishtili me mustaqe dhe Thëllëza e Malit). Gjithashtu 5 lloje të rrezikuara shpendësh takohen në Shqipëri si Pelikani kaçurel,

Pata ballëbardhë, etj. Lagunat bregdetare dhe liqenet e mëdhenj në brëndësi të vendit përfaqësojnë zona të rëndësishme veçanërisht për dimërimin e shpendëve migratorë.

Së paku katër prej këtyre ligatinave (Laguna e Karavastasë, Laguna e Nartës, Liqeni i Shkodrës dhe ai i Ohrit) mund të konsiderohen si Zona të një Rëndësie Ndërkombëtare për shpendët, të njohura me emrin IBA (Important Bird Area), dhe plotësojnë kushtet për të qënë si zona Ramsar (Karavastaja, Butrinti dhe Shkodra janë shpallur të tilla), me më shumë se 20,000 mijë shpendë dimëronjës uji secila.

Shqipëria si një vend mesdhetar i pasur me gëlqerorë dhe shpella, ofron varietete habitatesh që mund të përdoren si vende jetese për lakuriqët e natës. Rreth gjysma e llojeve të gjetura të

INFORMACION PËR NDËRVEPRIMIN NË MJEDIS “Linjen e Prodhimit të SO₂ dhe e mbushjes së bombolave e cisternave me SO₂“

UZINA 12 E ISH KOMBINATIT METALURGIK, BRADASHESH, ELBASAN.

lakuriqëve të natës njihen si lloje që jetojnë në shpella. Tynetet e ndërtuara në kohët e shkuara për qëllime ushtarake dhe shumica e minierave që nuk përdoren më, janë vende të vlefshme për lakuriqët e natës. Disa nga këto janë tashmë të populluara nga kolonitë e lakuriqëve të natës.

Një rast i veçantë është Shpella e Trenit që ndodhet në hyrje të Liqenit të Prespës së Vogël, dhe që është mbushur nga sedimentet e shkarkuara nga devijimi i Lumit Devoll këto 20-25 vjetët e fundit. Meqënëse kjo shpellë është bërë më e vogël dhe e tharë, ka humbur rëndësinë e saj për të bujtur koloni të vegjëlsh për disa lloje lakuriqësh, veçanërisht për *Miniopterus schreibersi*, *Myotis capaccinii* dhe *Myotis daubentoni* dhe *Eptesicus serotinus*.

1. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.

Ne zonen e zbatimit të këtij projekti ka burime ujore të identifikuar. Por këto burime ujore nuk ndodhen në brendësi të pronës/sipërfaqes në vlerësim, por në një distancë të afërt. Konkretisht burimi ujor më i afërt është Lumi Shkumbin. Përsa i përket distancave që objekti ruan me këto burime ujore sqarohet se Shtrati i Lumit Shkumbin kalon rreth 800m në vijë ajrore në jug të objektit. Zona është me reliev të sheshtë dhe ndodhet në brendësi të Kombinatit Metalurgjik. Objekti nuk ndodhet në brendësi të burimeve ujore të rëndësishme si Liqene, Laguna apo zona Bregdetare.

Me poshtë paraqitet një pamje e distancës që ruan objekti nga burimi ujor.


Foto të Lumit Shkumbin, pjesa e shtratit të Lumit, në zonen Bradashesh



INFORMACION PËR NDËRVEPRIMIN NË MJEDIS “Linjen e Prodhimit të SO₂ dhe e mbushjes së bombolave e cisternave me SO₂“

UZINA 12 E ISH KOMBINATIT METALURGIK, BRADASHESH, ELBASAN.

Fragment i rajonit nga harta e zonave të mbrojtura.



Monumentet Natyrore të Rrethit Elbasan. (Sipas VKM 676)

Nr.	Monumenti Natyror	Nr.	Monumenti Natyror
1	Frasheri i Polos Vale	13	Dushku i Kishes Gjinar
2	Pylli aluvial i Shushices	14	Lisat e Pashtreshit
3	Shpella e Letanit	15	Mani i Zi i Joronishtit
4	Hinka e Kosoves (Dumre)	16	Rrepet e Byshekut
5	Mali (Shkempi) i Gradishtes	17	Robulli i Zeleshnjës
6	Shpella e Gracenit	18	Rapi i Bezistanit
7	Liqenet e Seferanit	19	Rrapi i Vojvodes
8	Liqeni i Deges (Dumre)	20	Rrapi i Gurres së Labinotit
9	Burimi i Llixhes së Hibrait	21	Ulliri i Qejfit
10	Dushku i Lleshanit	22	Rrapi i Llixhes
11	Meshtekna e Zavalines	23	Rrapi i Uruçës
12	Pisha e Fushe Kuçes Gjinar		

2. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.

Ndikime të rëndësishme gjatë funksionimit të aktivitetit.

Shkarkime në ujë

Ky lloj aktiviteti përdor ujin në proceset industriale vetëm për sistemin ftohës. Janë dy depozita ftohëse (kondensatore) të cilat shndërrojnë gazin në lëng. Ky ujë, sipas deklarimeve të investitorit, është i pastër, nuk përzieret me asnjë komponent kimik, as lëndet e para, as produktin, ai qarkullon në anën e jashtme të kondensatoreve. Ky ujë pasi përdoret shkarkohet në rrjetin e kanalizimeve të zonës së Kombinatit Metalurgjik, ku kalon në kolektorin kryesor të Kombinatit për shkarkimin e tyre në mjediset e zonës. Sasia që përdoret në një ditë punë (për ato pak ditë në vit që funksionon impianti) është rreth 1.6m³.

Emetimet në ajër

Ky aktivitet për prodhimin e Gazit Sulfuror përdor Sulfur kristalin në formë coprash e kokrrizash mbi 3mm dhe në prani të pluhurit. Në këtë trajtë të kristalines, mundësia e ndotjes së mjedisit është relativisht e vogël. Megjithatë, subjekti ka ndërtuar një depo të mbyllur për ruajtjen dhe magazinimin e këtij produkti si lëndë e para në mënyrë që të mos jetë i ekspozuar nga kushtet klimatike, përhapja e tij nga era dhe shiu, etj.

Squfuri mund të vetëdizet në temperaturë të lartë që variojnë 140-250°C. Pra duke ditur këtë veti të Sqfurit, duhet që të ruhet një temperaturë kontante dhe të jetë e kontrolluar vazhdimisht që të mos arrijë temperaturën 140 °C, kuptohet që në zonën e Furrës ku realizohet edhe shkëmbimi, pasi në zonën e tjera kjo temperaturë praktikisht është e pamundur të arrihet. Sa më sipër, subjekti duhet të ketë marrë masat e nevojshme të mbrojtjes ndaj zjarrit si Hidrant Uji dhe bombula fikse zjarri dhe keto kushte duhet të mirëmbajë dhe të jenë gjithmonë funksionale. Lëndë të para të tjera që përdoren janë Glicerina ushqimore dhe oksigjeni të cilat blihen të gatshme gjithashtu. Këto lëndë janë të pastra përveç efektit të tyre në mjedis (krahasuar me lëndë të tjera të demshme siç është Gazi Sulfurik kur clirohet në atmosferë). Por gjithësesi, përdorimi i këtyre lëndëve duhet të jetë i kujdesshëm dhe nën mbikqyrjen e drejtuesit teknik (teknologut). Oksigjeni në rast të keqmenaxhimit të tij, mund të shkaktojë djegie ose eksplozion të cilat mund të demtojnë depozitën e gazit të demshëm për mjedisin por mbi të gjitha rrezikon jetën e punëtorëve që ndodhen në ambjentin e punës. Ndaj gjatë venies në punë të furrës apo gjatë kryerjes së shërbimeve të mirëmbajtjes, në asnjë rast nuk duhet që të preken me duar apo vegla punë të pastra e sidomos të ndotura me graso apo vaj. Këto kushte duhet të zbatohen rigorozisht nga drejtuesi teknik dhe nga punonjësit.

Glicerina përdoret për proceset e pastrimit të Gazit Sulfuror, ajo përdoret në sasi tepër të vogla, krahasuar me lëndët e para që janë Sqfuri dhe Oksigjeni. Ajo nuk është një problem për mjedisin e punës dhe as mjedisin fizik e biologjik në teresi.

Depozitimi i Gazit të prodhuar kryhet në një depozitë me kapacitet prej 75 Tona e me pas kryhet ambalazhimi në bombula prej kapaciteti 58kg. Këto bombula mbajnë një presion atmosferik deri në 6 Bar.

Gazi Sulfuror mund të jetë i pranishëm në mjediset e punës, sidomos pranë furrës së oksidimit, por edhe në nyjet e ngarkim-shkarkimit të gazit në depozitat e ambalazhit, pasi depozita kryesore është e lidhur drejtperdrejtë me procesin e prodhimit të tij dhe nuk ka hapësira komunikimi. Ky gaz, nëse thithet nepermjet sistemit të frymemarrjes shkakton

INFORMACION PËR NDËRVEPRIMIN NË MJEDIS “Linjen e Prodhimit të SO₂ dhe e mbushjes së bombolave e cisternave me SO₂“

UZINA 12 E ISH KOMBINATIT METALURGJIK, BRADASHESH, ELBASAN.

irritim të këtyre rrugëve dhe madje inflamacione të rënda të bronkëve dhe demtim të Melcise së zeze. Shkalla e demtimit varet edhe nga sasia dhe koha e ekspozimit ndaj këtij gazi.

Ndaj në këto kushte, rekomandohet që punonjësit që janë të rriskuar nga këto fenomene të përdorin Maskë kundër gazi, syze dhe veshje të posaçme. Këto masa me tepër janë të vlefshme në momentet kritik të një çlirimi të gazit nga pakujdesitë, avaritë në sistem, por edhe në kushte normale pune sado pak që të ekspozohet individ. Pajisjeve të punës duhet të kryhet hermetizim i plotë dhe të kolaudohen vazhdimisht për demtime të mundshme. Të kontrollohen vazhdimisht valvulat e sigurisë dhe mjedisi i punës të jetë gjithmone i hapur e i ventilluar (ajrosur).

Ky aktivitet nuk përdor furra me lëndë djegëse, nuk ka kalidaje, nuk ka prodhim energjie, nuk ka oxhaqe të shkarkimit të tymit apo gazeve të demshme për mjedisin.

Zhurmat dhe vibrimet

Ky aktivitet nuk shqerohet me zhurma të niveleve të larta në mjedisin e zonës, as në ambientet e punës. Për zonën ku ndodhet ky aktivitet nuk përben asnjë shqetësim për banorët e rajonit apo për mjedisin natyror. Punonjësit që mund të jenë të ekspozuar ndaj burimeve të larta të zhurmës si kompresore, gjeneratore, etj, duhet/mund të përdorin kufje kundër zhurmës.

Ndikimi në toke

Proceset e punës nuk ndikojnë në toke, pasi ambienti është i shtruar me beton dhe është kapaon i mbyllur. Materialet dhe lëndët e para ruhen në ambiente të mbyllura dhe nuk janë të ekspozuar ndaj kushteve klimaterike. Depertimi i ujërave të kontaminuar nëntokë është pothuajse i pamundur.

Ndikimi në Biodiversitet

Kjo zonë nuk bën pjesë në zonat e mbrojtura me ligj, aktiviteti nuk ndikon në asnjë fazë në biodiversitetin e mjedisit të zonës. Sipas deklarimeve të subjektit, ujërat që përdoren për sistemin ftohes, riqarkullojnë dhe nuk shkarkohen në mjedisin e zonës pa u trajtuar. Megjithatë këto ujëra shërbejnë për ftohjen e pajisjeve, ato kalojnë në një vaske dekantimi dhe pastaj rimerren për procesin teknologjik. Kjo zonë nuk është zonë pyjore në të cilën mund të jenë krijuar habitate të rëndësishme.

Ndikimi në Mjedisin Social

Ndikimi i këtij projekti në mjedisin social, vlerësohet të jetë pozitiv përse i përket punësimit, shërbimit të ofruar dhe kontributit në GDP sado i vogël qoftë, duke eksportuar prodhimin vendas. Duke qenë se në këto zone ka specialiste të këtij lloji profesioni kjo është edhe një mundësi punësimi ose vetëpunësimi për këta të fundit.

Mbetjet e prodhuara

Mbetje të ngurta që mund të prodhohen janë ato të skorjeve që prodhon furra (Trajta Guresh). Këto mbetje, prodhohen nga papastërtitë që mund të ketë Squfuri si lëndë e parë, që nuk zë më shumë se 1-2% të tij. Këto mbetje mund të jenë lloj qymyri dhe sasia e prodhimit të tyre për gjithë vitin, nga i cili punohet vetëm 1-2 muaj është rreth 40 kg. Këto mbetje duke qenë në trajtë të ngurta dhe të pa tretshme, nuk përbejnë problem për kontenerin e mbetjeve të ngurta të Kombinatit Metalurgjik. Ato depozitohen për menaxhim të bashkuar me mbetjet e ngurta të llojeve të tjera të gjithë kombinatit. Këto mbetje duhet të menaxhohen duke u depozituar dhe sistemuar kundër ekspozimit ndaj efektit të erozionit dhe përhapjes së tyre në mjedis. Këto mbetje duhet të menaxhohen nga një subjekt i licensuar dhe që plotëson kriteret për menaxhimin e tyre.

3. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.

Informacion për shkarkimet në mjedis.

Ky lloj aktiviteti përdor ujin në proceset industriale vetëm për sistemin ftohës. Janë dy depozita ftohëse (kondensatore) të cilat shndërrojnë gazin në lëng. Ky ujë, sipas deklarimeve të investitorit, është i pastër, nuk përzieret me asnjë komponent kimik, as lëndet e para, as produktin, ai qarkullon në anën e jashtme të kondensatoreve. Ky ujë pasi përdoret shkarkohet në rrjetin e kanalizimeve të zonës së Kombinatit Metalurgjik, ku kalon në kolektorin kryesor të Kombinatit për shkarkimin e tyre në mjediset e zonës. Sasia që përdoret në një ditë punë (për ato pak ditë në vit që funksionon impianti) është rreth 1.6m³.

Ky aktivitet për prodhimin e Gazit Sulfuror përdor Sulfur kristalinë në formë coprash e kokrrizash mbi 3mm dhe në prani të pluhurit. Në këtë trajtë të kristalines, mundësia e ndotjes së mjedisit është relativisht e vogël. Megjithatë, subjekti ka ndërtuar një depo të mbyllur për ruajtjen dhe magazinimin e këtij produkti si lëndë e parë në mënyrë që të mos jetë i ekspozuar nga kushtet klimatike, përhapja e tij nga era dhe shiu, etj.

Sqfuri mund të vetëndizet në temperatura të larta që variojnë 140-250°C. Për të ditur keto veti të Sqfurit, duhet që të ruhet një temperaturë kontante dhe të jetë e kontrolluar vazhdimisht që të mos arrijë temperaturën 140°C, kuptohet që në zonën e Furrës ku realizohet edhe shkrirja, pasi në zonën e tjera kjo temperaturë praktikisht është e pamundur të arrihet. Sa më sipër, subjekti duhet të ketë marrë masat e nevojshme të mbrojtjes ndaj zjarrit si Hidrant Uji dhe bombula fikse zjarri dhe keto kushte duhet të mirëmbajë dhe të jenë gjithmonë funksionale. Lëndë të para të tjera që përdoren janë Glicerina ushqimore dhe oksigjeni të cilat blihen të gatshme gjithashtu. Keto lëndë janë të pastra përse i perkete efektit të tyre në mjedis (krahasuar me lëndë të tjera të demshme siç është Gazi Sulfurik kur clirohet në atmosferë). Por gjithsesi, përdorimi i këtyre lëndëve duhet të jetë i kujdesshëm dhe nën mbikqyrjen e drejtuesit teknik (teknologut). Oksigjeni në rast të keqmenaxhimit të tij, mund të shkaktojë djegie ose eksplozion të cilat mund të demtojnë depozitën e gazit të demshëm për mjedisin por mbi të gjitha rrezikon jetën e punëtorëve që ndodhen në ambjentin e punës. Ndaj gjatë venies në punë të furrës apo gjatë kryerjes së shërbimeve të mirëmbajtjes, në asnjë rast nuk duhet që të preken me duar apo vegla punë të pastra e sidomos të ndotura me graso apo vaj. Keto kushte duhet të zbatohen rigorozisht nga drejtuesi teknik dhe nga punonjësit.

Glicerina përdoret për proceset e pastrimit të Gazit Sulfuror, ajo përdoret në sasi tëper të vogla, krahasuar me lëndet e para që janë Sqfuri dhe Oksigjeni. Ajo nuk është një problem për mjedisin e punës dhe as mjedisin fizik e biologjik në teresi.

Depozitimi i Gazit të prodhuar kryhet në një depozitë me kapacitet prej 75 Tones e me pas kryhet ambalazhimi në bombula prej kapaciteti 58kg. Keto bombula mbajnë një presion atmosferik deri në 6 Bar.

Gazi Sulfuror mund të jetë i pranishëm në mjediset e punës, sidomos pranë furrës së oksidimit, por edhe në nyjet e ngarkim-shkarkimit të gazit në depozitat e ambalazhit, pasi depozita kryesore është e lidhur drejtperdrejtë me procesin e prodhimit të tij dhe nuk ka hapësira komunikimi. Ky gaz, nëse thihet nepermjet sistemit të frymemarrjes shkakton irritim të këtyre rrugëve dhe madje inflamacione të rëndë të bronkëve dhe demtim të Melcise së zeze. Shkalla e demtimit varet edhe nga sasia dhe koha e ekspozimit ndaj këtij gazi. Ndaj në keto kushte, rekomandohet që punonjësit që janë të rriskuar nga keto fenomene të përdorin Maska kundër gazi, syze dhe veshje të posacme.

Keto masa me tëper janë të vlefshme në momentet kritik të një çlirimi të gazit nga pakujdesite, avarite në sistem, por edhe në kushte normale punë sado pak që të ekspozohet individit. Pajisjeve të punës duhet tu kryhet hermetizim i plotë dhe të kolaudohen vazhdimisht

per demtime te mundshme. Te kontrollohen vazhdimisht valvulat e sigurise dhe mjedisi i punes te jete gjithmone i hapur e i ventiluar(ajrosur).

Ky aktivitet nuk perdor furra me lende djegese, nuk ka kaldaje, nuk ka prodhim energjie, nuk ka oxhaqe te shkarkimit te tymit apo gazeve te demshme per mjedisin.

Ky aktivitet nuk shoqerohet me zhurma te niveleve te larta ne mjedisin e zones, as ne ambientet e punes. Per zonen ku ndodhet ky aktivitet nuk perben asnje shqetesim per banoret e rajonit apo per mjedisin natyror. Punonjesit qe mund te jene te ekspozuar ndaj burimeve te larta te zhurmes si kompresore, gjeneratore, etj, duhet/mund te perdorin kufje kunder zhurmes.

Mbetje te ngurta qe mund te prodhohen jane ato te skorjeve qe prodhon furra(Trajte Guresh). Keto mbetje, prodhohen nga papastertite qe mund te kete Squfuri si lende e pare, qe nuk ze me shume se 1-2% te tij. Keto mbetje mund te jene lloj qymyri dhe sasia e prodhimit te tyre per gjithe vitin, nga i cili punohet vetem 1-2 muaj eshte rreth 40 kg. Keto mbetje duke qene ne trajte te ngurte dhe te pa tretshme, nuk perbejne problem per kontenierin e mbetjeve te ngurta te Kombinatit Metalurgjik. Ato depozitohen per menaxhim se bashku me mbetjet e ngurta te llojeve te tjera te gjithe kombinatit. Keto mbetje duhet te menaxhohen duke u depozituar dhe sistemuar kunder ekspozimit ndaj efektit te erozionit dhe perhapjes se tyre ne mjedis. Keto mbetje duhet te menaxhohen nga nje subjekt i licensuar dhe qe ploteson kriteret per menaxhimin e tyre.

4. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.

Ndikimi i aktivitetit ne kushte normale funksionimi do te zgjase per aq kohe sa zgjat edhe aktiviteti. Ne kushte normale funksionimi, aktiviteti nuk ka ndikim mbi mjedisin, ndersa ne rast te ndonje keqfunksionimi, apo avarie ne sistem dhe rrjedhjes se Gazit SO₂ ne atmosfere, ky gaz shnderrohet ne nje ndotes potencial te ambientit. Ky lloj Gazi klasifikohet ne llojet e gazeve "Sere" te cilet kontribuojne ne krijimin dhe rritjen e efektit Sere dhe per pasoje edhe ngrohjen globale.

5. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS

Ndikimi ne mjedisin e zones ne kushte normale te punes, nuk perhapet ne nje distance te larget, ndersa persa i perkete efektit te ketij gazi ne rast te clirimit te tij ne atmosfere, ai shkakton ndotje te atmosferes dhe efekti i tij mund te shtrihet ne disa kilometra nga vendi i burimit. Ndaj eshte shume e rendesishme qe subjekti te zbatoje kushtet teknike ne pune dhe te ruaj masa te larta sigurie fizike e kunder renieve te zjarrit ne objekt.

6. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.

Subjekti, duhet te kujdeset per nje mjedis te paster, te rregullt, te gjelberuar, te sigurte dhe te pajisur me sinjalistiken dhe posterat sensibilizues perkates per kushtet teknike dhe per mbrojtjen e mjedisit. Keshtu subjekti ka detyrimin qe te zbatoje kushte te larta higjenike, sigurie fizike dhe ndaj renies se zjarreve ne objekt. Mjedisin perreth objektit te ruhet i paster dhe i kendshem, te mos kontaminohet me materiale te tilla si lenda e pare apo skorje te ndryshme te mundshme.

7. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.

Ne mënyrë të përgjithshme do të japim disa prej masave që duhet të zbatohen nga investitori për mbarefunksionimin e aktivitetit dhe ruajtjen e mjedisit fizik e biologjik.

- Gazi Sulfuror mund të jetë i pranishëm në mjediset e punës, sidomos pranë furrës së oksidimit, por edhe në nyjet e ngarkim-shkarkimit të gazit në depozitat e ambalazhit. Si rrjedhojë subjekti duhet të kujdeset për një proces pune dhe cikël hermetik dhe plotësisht të mbyllur.
- Subjekti është përgjegjës që punonjësit që janë të rriskuar nga këto fenomene të përdorin maska kundër gazit, syze dhe veshje të posaçme.
- Pajisjeve të punës dhe bombolave të ambalazhit, por edhe depozitës kryesore, duhet të kryhet kolaudim periodik, pra në mënyrë të vazhdueshme, në mënyrë që të shmangen mundësitë e rrjedhjes së gazit apo të eksplozionit.
- Të kontrollohen vazhdimisht valvulat e sigurisë dhe mjedisi i punës të jetë gjithmone i hapur e i ventiluar (i mirë ajrosur).
- Të zbatohen kushte të larta sigurie fizike dhe të mbrojtjes nga zjarri në objekt. Të montohen postera sensibilizues dhe të këtu roje të sigurisë fizike 24 orë në ditë.
- Të mirëmbahen mjetet e mbrojtjes nga zjarri si hidrante dhe bombula kundër zjarrit. Këto të fundit të kontrollohen rregullisht nga ekspertet e zjarrfikses dhe të rinovohet çdo vit Akti-Teknik i mbrojtjes nga zjarri.
- Të mos hidhen mbetje në mjedisin e zonës, qofshin këto skorje apo lende e pare squfur. Ato të menaxhohen nga subjekti që menaxhojnë mbetjet e ngurta.
- Subjekti të jetë në dijeni të gjithë kuadrit ligjor në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe zbatimin të kushteve teknike në mjediset e punës dhe të ndryshimeve që kryhen në këto të fundit.

8. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR.

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhojë edhe ndikimi i tij nuk shkakton demtim të mjedisit ndërkufitar. Për këtu kapitull, nuk kryhen vlerësime dhe analiza të detajuara për shkak të vendodhjes së projektit në brendësi të kufirit shtetëror dhe distancës që ai ruan me kufirin dhe shtet fqinjë.

Studio Elbasani
Eksperte mjedisore
Lila Karaj